



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 244/5 prot.

Tiranë, më 9.7.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 255, datë 8.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Ludovik Dodaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.6.2020, është njoftuar vendimi nr. 255, datë 8.6.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Ludovik Dodaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga data e njoftimit.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 255, datë 8.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka punuar si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Kukës, në vitet 1983-1988, prokuror në Prokurorinë e Apelit Shkodër, në vitet 1988-1992, zëvendësprokuror në Prokurorinë e Rrethit Shkodër, në vitet 1993-1998, prokuror Rrethi në Prokurorinë Shkodër,

në vitet 1998-2002, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në vitet 2002 e në vazhdim.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Ludovik Dodaj²”, ka referuar për subjektin, se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Ludovik *** Dodaj³, i ka referuar Komisionit “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

3.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për aftësitë profesionale, të subjektit të rivlerësimit z. Ludovik Dodaj, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI, me nr. *** prot., datë ***.5.2018.

³ Raporti me nr. *** prot., datë ***.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.9.2019.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë ***.12.2019.

subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor. Subjekti rezulton me një bilanc negativ në vitin 2008, në shumën 358.816 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në vitin 2008 nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 14-15 e vendimit). Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë Deklaratën e Kontrollit të Figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se: subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. [...] (f. 18 e vendimit).*

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLP, hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku, ka konkluduar se: [...] *Nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 21 e vendimit).*

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të

Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 255/2020, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si organi gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

11. Ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe shkaqe lidhur me nevojën për kontrollin e vendimit të Komisionit që lidhem me: (i) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarinë e subjektit për pasurinë e paluajtshme, të llojit apartament banimi; (ii) deklarime të pasakta/pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite, nga ana e subjektit; (iii) pamundësinë financiare të huadhënësit, z. ***.***, për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë subjektit të rivlerësimit; (iv) pamjaftueshmërinë financiare për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet për vitet 2013-2014; (v) çështje të tjera lidhur me vlerësimin e etikës profesionale të subjektit.

12. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit.

13. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 255, datë 8.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II.A. Analiza e shkaqeve të ankimit

II.A.1 Kontrolli i pasurisë

14. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Rezulton se subjekti i rivlerësimit z. Ludovik Dodaj, është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "*Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e

interesave private periodike për vitet 2003-2016 (në vijim DV-20..) dhe, në datë 27.1.2017, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016.

16. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

17. Pasuria nr. 1, “Apartament me sip. 108.48 m²”, ndodhur në lagjen nr. *, Durrës (në vijim referuar si “Apartament me sip. 108.48 m²”)**

17.1 Në D-Vett., subjekti deklaron: Apartament banimi 2+1, me nr. pasurie *** nd *** Z. K. ***, vol. ***, f.***, me sip. totale 108,48 m², ndodhur në lagjen nr.***, ***, Durrës. Blerë me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.10.2013, me vlerë 45.000 euro. *Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshorten znj. ***.***. Burimi i krijimit, deklaruar si më poshtë:*

17.1.1 *Kësti i parë*, në vlerën 25.000 euro, është paguar *cash* sipas kontratës së sipërmarrjes me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, dhe pjesa tjetër me këste. *Burimi i krijimit: i)* 1.900.000 lekë, përfituar nga shitja e shtëpisë në Shkodër⁵; *ii)* 300.000 lekë, përfituar nga shitja e pajisjeve të shtëpisë; *iii)* Kursimet ndër vite deri në vitin 2006.

17.1.2 *Kësti i dytë*, në vlerën 7.000 euro, është paguar në vitin 2007. *Burimi i krijimit: Kredi e marrë nga Banka ***.*** (në vijim referuar si ***), në shumën 1.200.000 lekë, në datë ***.12.2006. Qëllimi i kredisë: pagesë kësti prej 7.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe blerje pajisje shtëpie.*

17.1.3 *Kësti i tretë*, në vlerën 4.000 euro, është paguar në vitin 2008. *Burimi i krijimit: Kursimet familjare.*

17.1.4 *Kësti i katërt*, në vlerën 4.000 euro, është paguar në vitin 2009. *Burimi i krijimit: Hua e marrë nga kunati im, z. ***.***, me banim në Greqi, në shumën 8.000 euro, për të shlyer kredinë e vitit 2006.*

17.1.5 *Kësti i pestë*, në vlerën 5.000 euro, është paguar në vitin 2012, me *burim krijimi* nga kursimet.

17.1.6 Në DV-2003, subjekti deklaron: *Cash* në banesë, në shumën 2.200.000 lekë, me *burim krijimi* nga shitja e shtëpisë në Shkodër, sipas kontratës nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2003⁶.

17.1.7 Në DV-2005, subjekti deklaron: Depozitë me afat 3-mujor, pranë *** Bank, në shumën 7.000 USD, krijuar në datën ***.7.2005. *Nuk deklarohet burimi i krijimit.*

17.1.8 Në DV-2006, subjekti deklaron: Kontratë sipërmarrje me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, për shtëpi banimi, apartament (2+1), me sipërfaqe 110.48 m², me vlerë 45.000 euro, nga të cilat janë paguar 25.000 euro. *Nuk deklarohet burimi i krijimit.* Në po të njëjtin formular, *në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”*, subjekti deklaron: Kredi e marrë nga *** Durrës, për shtëpi me vlerë 1.200.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006, me afat shlyerje deri në ***.12.2011.

17.1.9 Në DV-2007, *në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”*, subjekti deklaron: (i) Sipas kontratës nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, për shtëpi banimi, detyrimi për t’u paguar është në shumën 20.000 euro, nga të cilat janë shlyer 7.000 euro, dhe mbetur për t’u paguar 13.000 euro të tjera. (ii) Referuar kontratës së kredisë me ***

⁵ Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, me nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2009.

⁶ Çmimi i shitjes sipas kësaj kontrate është caktuar në shumën 1.900.000 lekë, likuiduar mes palëve jashtë zyrës noteriale.

nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006, detyrimi tjetër i mbetur për t'u paguar është në shumën 1.030.767 lekë. *Nuk deklarohet burimi i të ardhurave që janë përdorur për shlyerjen e këstit.*

17.1.10 Në DV-2008, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaron: (i) Sipas kontratës së sipërmarrjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, e deklaruar në 2007, janë shlyer 4.000 euro dhe mbetur për t'u paguar 9.000 euro. (ii) Referuar kontratës së kredisë me *** nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006, detyrim i mbetur për t'u paguar, është në shumën 823.620 lekë. *Nuk deklarohet burimi i të ardhurave që janë përdorur për shlyerjen e këstit prej 4.000 euro.*

17.1.11 Në DV-2009, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaron: (i) Hua në shumën 8.000 euro, nga kunati z. ***.***, me banim në Greqi; (ii) Sipas kontratës së sipërmarrjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, e deklaruar në 2007, janë shlyer 4.000 euro, dhe mbetur për t'u paguar 5.000 euro; (iii) Shlyerje e plotë e detyrimit të mbetur sipas kontratës së kredisë me *** nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006, në shumën 840.000 lekë. *Nuk deklarohet burimi i të ardhurave të përdorura për shlyerjen e parakohshme të kredisë pranë *** dhe burimi i të ardhurave për këstin prej 4.000 euro.*

17.1.12 Në DV-2012, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaron: Me mandatarkëtimin datë ***.10.2012, të shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 5.000 euro, është shlyer tërësisht detyrimi sipas kontratës së sipërmarrjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006. *Nuk deklarohet burimi i të ardhurave të përdorura për likuidimin e këstit të fundit të apartamentit prej 5.000 euro.*

17.2 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se veprimi juridik origjinar mbi këtë pasuri të paluajtshme është Kontrata e sipërmarrjes⁷ nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2006, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe subjektit të rivlerësimit z. Ludovik Dodaj, në cilësinë e porositësit. Ndërkohë, Kontrata e shitblerjes e kësaj pasurie të paluajtshme, me nr. *** rep., nr.*** kol., është lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***, në cilësinë e blerësit, datë ***.10.2013.

17.3 Konstatohet se bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në D-Vett. dhe në deklaratimet e interesave private periodike/vjetore, DV-2006, DV-2008, DV-2009 dhe DV-2012, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, sikurse u parashtrua më lart, çmimi i blerjes për këtë pasuri të paluajtshme është paguar me pesë këste, në këto intervale: Kësti i parë, në shumën 25.000 euro, është paguar në vitin 2006. Kësti i dytë, në shumën 7.000 euro, është paguar në vitin 2007. Kësti i tretë, në shumën 4.000 euro, është paguar në vitin 2008. Kësti i katërt, në shumën 4.000 euro, është paguar në vitin 2009. Kësti i pestë, në shumën 5.000 euro, është paguar në vitin 2012.

17.4 Komisioni nga analiza financiare e kryer për vitet 2006-2012, ka konkluduar se subjekti rezulton me mungesë mjeteshe financiare vetëm për vitin 2008.

17.5 Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin lidhur me mundësinë financiare të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kryera nga subjekti në vitet 2006, 2008 dhe 2009.

⁷ Modalitetet e pagesës sipas kësaj kontrate: -15.000 euro janë paguar nga porositësi dhe janë marrë në dorëzim nga sipërmarrësi; - 10.000 euro do të paguhen brenda muajit gusht 2006; - 5.000 euro do të paguhen brenda muajit janar 2007; - 5.000 euro do të paguhen brenda muajit qershor 2007; - 10.140 euro do të paguhen brenda muajit dhjetor 2007.

17.6 Lidhur me burimin, për pagesën e këstit të parë, në shumën 25.000 euro, deri në datën 21.8.2006. Referuar deklaramëve të subjektit në DV-Vett. dhe marrë në konsideratë mandatet⁸ e pagesave të shoqërisë “****” sh.p.k., paraqitur si provë nga subjekti, rezulton se subjekti, deri në datën 21.8.2006, ka shlyer pjesërisht detyrimin për apartamentin në shumën 25.000 euro.

17.7 Në analizë të burimeve të deklaruara për këstin e parë rezulton si vijon:

17.8 Lidhur me burimin: “1.900.000 lekë, përfitur nga shitja e shtëpisë në Shkodër”, nga aktet në dosjen e Komisionit rezulton se me kontratë shitblerje me *** rep., *** kol., datë ***.6.2003, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij e kanë shitur “apartamentin me sip. 73 m²”, të ndodhur në Shkodër, te z. ***.*** dhe znj. ***.***, kundrejt çmimit 1.900.000 lekë, shumë e cila është likuiduar në mes palëve jashtë zyrës noteriale.

17.9 Lidhur me burimin, “300.000 lekë, përfitur nga shitja e pajisjeve të shtëpisë”. Në DV-2003, subjekti deklaron: *Cash në banesë, në shumën 2.200.000 lekë, me burim krijimi nga shitja e shtëpisë në Shkodër, sipas kontratës nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2003.* Nga aktet në dosje, konstatojmë se Komisioni, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pagesave të kryera në vitin 2006, ka kryer analizë të plotë vjetore për periudhën nga 1.1.2006-31.12.2006, duke përfshirë në analizë si një nga burimet e ligjshme shumën totale prej 2.200.000 lekësh, duke arsyetuar si vijon: [...] *Subjekti ka deklaruar se ka përfitur një shumë prej 300.000 lekë nga shitja e mobilieve të këtij apartamenti, por pa dorëzuar dokumentacion provues. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar shkresa të thjeshta për të provuar shitjen e mobilieve. Komisioni vlerëson se pavarësisht njohjes apo jo të shumës 300.000 lekë (si e ardhur nga shitja e mobilieve), subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash në shumën 2.200.000 lekë të deklaruar, në DV- 2003 [...].*

17.10 Lidhur me arsyetimin e Komisionit se: [...] *pavarësisht njohjes apo jo të shumës 300.000 lekë (si e ardhur nga shitja e mobilieve), subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash në shumën 2.200.000 lekë, të deklaruar në DV-2003 [...], Komisioneri Publik çmon se ky arsyetim është përtej deklaramëve dhe pretendimeve të vetë subjektit të rivlerësimit.*

17.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shuma e të ardhurave të realizuara nga shitja e pajisjeve shtëpiake prej 300.000 lekë nuk duhet të merret në konsideratë në situatën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, pasi burimi i kësaj shume nuk rezulton të jetë deklaruar në DV-2003. Ky qëndrim i Komisionerit Publik bazohet në jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht në vendimin (JR) nr. 7/2018, datë 9.7.2018 (pgr. 62) dhe vendimin (JR) nr. 34/2019, datë 2.12.2019 (pgr. 63/2 dhe 64/1).

17.12 Lidhur me burimin: “Kursime ndër vitet, deri në vitin 2006”, nga aktet në dosje konstatohet se:

17.12.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit në DV - 2003-2006 të ketë deklaruar posedimin e kursimeve të tjera *cash*, përveç shumës së deklaruar në DV-2003, sikundër analizuar më sipër në burimin (i). Ndërsa në DV-2005 ka deklaruar depozitë pranë *** Bank, në shumën 7.000 USD, pa referuar burimin e krijimit.

17.12.2 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, i përcjellë nga *** Bank me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2019, konfirmohet kjo depozitë bankare e subjektit. I pyetur nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozitë bankare, në përgjigjet e pyetësorit, datë 13.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë është pjesë e të ardhurave nga shitja e shtëpisë në Shkodër. Mbështetur në deklarinim e subjektit

⁸ Mandat nr. ****, datë 7.1.2006, për vlerën 5.000 euro, Mandat nr.****, datë 26.5.2006, për vlerën 10.000 euro, mandat nr. ****, datë 21.8.2006, për vlerën 10.000 euro.

rezulton se shuma 7.000 USD është pjesë e shumës 1.900.000 lekë, të përfituara nga shitja e apartamentit në Shkodër.

17.12.2.1 Për sa më sipër analizuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhet të konsiderohen si burime të ligjshme për shlyerjen e pagesave të apartamentit gjatë vitit 2006, vetëm shuma 1.900.000 lekë, e përfituar sipas kontratës së shitblerjes së apartamentit Shkodër, si dhe tërheqjet në *cash* nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nga data 1.1.2006 - 21.8.2006⁹, që në total rezultojnë të jenë në shumën 1.022.152 lekë¹⁰.

17.12.2.2 Në vlerësim të argumenteve të mësipërme, rezulton se burimet e ligjshme në dispozicion të subjektit të rivlerësimit deri në datën 21.8.2006 janë në vlerën 2.922.152 lekë. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1.1.2006 - 21.8.2009 janë në shumën 310.412 lekë¹¹. Pagesat e kryera deri në 21.8.2006 për këstin 25.000 euro ose 3.075.700 lekë¹², nuk mbulohen për një diferencë negative prej - **463.959 lekësh**.

18. Lidhur me burimin, për pagesën e këstit të tretë në shumën 4.000 euro, në datë 11.7.2008¹³

18.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2008 nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e këstit të tretë të apartamentit për një diferencë negative prej - **358.816 lekë**. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit¹⁴.

18.2 Në përfundim, Komisioni, ka arsyetuar se: [...] *pasi analizoi shpjegimet e subjektit, çmon se nisur nga vlera e këtyre shpenzimeve, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre shpenzimeve të pambuluara, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se balanca negative në vitin 2008, nuk mund të shërbejë si shkak i vetëm për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 [...]*¹⁵.

18.3 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se kjo diferencë, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, thëllon pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003-2016.

19. Lidhur me burimin: "Hua nga kunati, z. *.***, në shumën 8.000 euro", për pagesën e këstit të katërt, në datën 16.9.2009**¹⁶

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë hua e ka përdorur si burim: (i) për pagesën 4.000 euro të këstit të radhës të shtëpisë dhe (ii) për shlyerjen e kredisë të vitit 2006.

19.2 Për të provuar aftësinë huadhënëse të kunatit të tij, subjekti ka paraqitur si provë dokumentacion nga organet tatimore të shtetit grek, që vërteton të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij për vitet 2005 e në vazhdim.

19.3 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka arsyetuar se: [...] *subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit ka depozituar dokumentet "shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat e personave fizikë në bazë të deklarimit fillestar" të z. ***.***, për periudhën 2005-2014. Bazuar në këtë dokumentacion rezulton se kunati i*

⁹ Kjo datë përkon me datën kur është paguar plotësisht shuma 25.000 euro.

¹⁰ Shumë kjo që përfshin edhe interesat e përfituara nga depozita në USD, në vlerën 114.57 USD (ekuivalenti në lekë sipas kursit të këmbimit të BSH-së është në vlerën 11.152 lekë).

¹¹ Referuar të dhënave të përdorura nga Komisioni bazuar në INSTAT.

¹² Llogaritur me kursin e këmbimit të BSH-së në datat e kryerjes së pagesave.

¹³ Sipas mandatit të arkëtimit të shoqërisë "****" sh.p.k., nr. ***, datë 11.7.2008, për vlerën 4.000 euro.

¹⁴ Referohuni f. 7 së rezultateve të hetimit në dosjen e KPK-së.

¹⁵ Referohuni f. 9 së vendimit të KPK-së.

¹⁶ Sipas mandatit të arkëtimit të shoqërisë "****" sh.p.k., datë 16.9.2009, për vlerën 4.000 euro.

subjektit, për periudhën 2005-2009, ka krijuar të ardhura në shumën 54.413 euro, të cilat janë të mjaftueshme për dhënien e huas 8 000 euro [...].

19.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, pasi nuk rezultojnë që Komisioni të ketë konsideruar në analizë dhe shpenzimet e jetesës së familjes së personit tjetër të lidhur, të përbërë prej katër anëtarësh.

19.5 Po ashtu, nga aktet në dosje¹⁷ rezultojnë që shlyerja e parakohshme e kredisë është kryer në datën 3.2.2009, rrjedhimisht, subjekti këtë shumë e ka pasur në dispozicion më së paku në këtë datë. Të ardhurat e realizuara nga huadhënësi dhe bashkëshortja e tij për vitet 2005-2008 janë në shumën 42.092 euro, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar njëkohësisht shpenzimet e jetesës së personit tjetër të lidhur në shtetin grek¹⁸ edhe huan e deklaruar, dhënë subjektit të rivlerësimit.

19.6 Për sa më sipër Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme huan e deklaruar dhe, rrjedhimisht, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e parakohshme të kredisë në datën 3.2.2009, si dhe shlyerjen e këstit të apartamentit, në datën 16.9.2009, për një diferencë negative më së paku prej **-1.007.760 lekë**¹⁹.

19.7 Në përfundim, për këtë pasuri të paluajtshme, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat dhe shpenzimet e kryera për një diferencë negative në total prej **-1.830.535 lekë**.

20. Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare për vitet 2013-2014

20.1 Nga aktet në dosje, konstatojmë se Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën e deklarimit nga subjekti, 2003-2016. Nga analiza financiare, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitin 2013, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet, për një diferencë negative në shumën -97.738 lekë, ndërsa për vitin 2014, i ka rezultuar se mbulohen me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e kryera nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

20.2 Në analizën përkatëse financiare, Komisioni, ndër të tjera, për vitet 2013 dhe 2014, ka pakësuar kursimet *cash*, të padeklaruara si pakësime nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore respektive. Konkretisht, në analizën financiare të vitit 2013, ka pakësuar kursimet në *cash* të viteve paraardhëse (2008-2012) në vlerën 560.416 lekë, ndërsa në vitin 2014 ka pakësuar kursimet *cash*, të viteve paraardhëse për vlerën 700.550 lekë.

20.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, treguesit e analizës financiare të realizuar nga Komisioni, lidhur me gjendjen *cash*/kursimet ndër vite, duhej të bazoheshin vetëm mbi sa ka deklaruar vetë subjekti i rivlerësimit në DV periodike, për vitet përkatëse.

20.4 *Lidhur me deklaratat e subjektit në DV periodike mbi kursimet në cash*, Komisioneri Publik nënvizon se deklaratat periodike vjetore kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit, dhe, rrjedhimisht, në analizën financiare, duhej të ishin llogaritur kursimet në *cash* sipas deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit, si për shumën e deklaruara të kursyera, ashtu edhe për burimin e deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

¹⁷ Nga dokumentacioni bankar, i përcjellë nga ***, me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2019.

¹⁸ Mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të KPA-së, për periudhën 2005-2008, shpenzimet e jetesës për një familje me katër anëtarë në shtetin grek, llogariten në shumën 50.737 euro.

¹⁹ Kjo shumë përfaqëson ekuivalentin e shumës së marrë hua nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 8.000 euro që, bazuar në kursin e këmbimit sipas BSH-së, datë 3.2.2006 (datë kur huaja është përdorur për shlyerjen e parakohshme të kredisë), llogaritet në vlerën 1.007.760 lekë (8.000 * 125.97).

20.5 Konkluzioni i mësipërm i Komisionerit Publik mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ku Kolegji ka trajtuar në disa vendime detyrimin për deklarim dhe vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore²⁰.

20.6 Komisioneri Publik, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI konstaton se, subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore nga DV-2008 e në vijim ka deklaruar: *shtesat* e kursimeve cash me burim nga kursimet e të ardhurave vjetore dhe në asnjë nga deklaratat periodike vjetore, *nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësim të kursimeve cash*.

20.7 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se përlogaritjet e Komisionit, përveçse nuk përputhen me çfarë ka deklaruar subjekti në deklaratat periodike vjetore, bien ndesh edhe me orientimin e Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 7/2019, prg. 39., si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 11/2019 (prg. 27.12.18); vendimin (JR) nr. 19/2019 (prg. 84).

20.8 Në këto rrethana rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në këto vite, për diferencat negative respektivisht - **658.154 lekë** në vitin 2013 dhe **-649.771** në vitin 2014.

21. Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në argumentimin e mësipërm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstaton se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet me një diferencë negative në total prej **-3.138.460 lekë**, referuar nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bën që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

II.A.2 Çështje të tjera lidhur me kriteret e vlerësimit mbi etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

22. Komisioneri Publik vlerëson se, referuar tri kriterëve të procesit të rivlerësimit, vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të ndërthurura me vlerësimin e aftësisë profesionale, luan një rol të veçantë në përmbushjen e misionit të rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

23. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë përcaktuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një masë të jashtëzakonshme e të përkohshme, brenda së cilës, objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale është verifikimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, legjisllacionin që rregullon statusin e magjistratëve dhe akteve ndërkombëtare të fushës²¹.

24. Edhe pse në referencë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin e tij (JR) nr. 27/2019, prgr. 69 dhe 70, Komisioneri Publik shkaqet e këtij ankimi në lidhje me kriterin e pasurisë i gjen të mjaftueshme për të kërkuar para Kolegjit zbatimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për vetë rëndësinë që ka vlerësimi i etikës profesionale të magjistratëve në procesin e rivlerësimit, çmon të parashtrijë gjetjet përkatëse.

25. Nga përmbajtja e akteve mbi të cilat është bazuar vendimi nr. 255/2020 i Komisionit, Komisioneri Publik konstaton se disa nga faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

²⁰ Referohuni prg. 42, vendim (JR) nr. 9/2018; prg. 23, vendim (JR) nr. 5/2019, në prg. 22.14, vendim (JR) nr. 19/2019 etj.

²¹ Referohuni “Parimeve themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” të OKB-së, 1985; “Parimeve të Bangalor-it për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002; “Udhëzuesit Evropian për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve”, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë, 2005.

mungojnë të jenë vlerësuar nga Komisioni, referuar kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale, të përcaktuara në nenin 71, germa “c” dhe nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016²².

26. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin e datës 13.11.2019, në përgjigje të pyetjes së Komisionit se ku ka pasur vendbanimin e familjes së tij deri në momentin e blerjes së shtëpisë, ka deklaruar se: [...] *“Nga muaji shtator i vitit 2002 deri në qershor 2003 kam qëndruar në banesën në pronësi të z. ****.***j. ... Shtetasi ****.*** është i zonës sime dhe kemi njohje familjare të hershme dhe më ka ofruar ndihmën e tij vetëm për këtë shkak... Ndërsa nga qershori i vitit 2003 deri në nëntorin e vitit 2006 kam banuar në shtëpinë e z. ****.***, e regjistruar në zonën kadastrale ****, me numër pasurie **** ND ****, apartament, në lagjen nr. ****, rruga “****.***”, Durrës. Në këtë banesë kam qëndruar pa kundërshpërblim, pasi me këtë person kishim njohje familjare dhe, duke ditur pamundësinë time për të blerë menjëherë shtëpi në Durrës, më ka mundësuar të strehohem me familjen deri në momentin që unë do të blija apartamentin tim [...]”.*

27. Nisur nga nevojat e hetimit lidhur me këta shtetas, pas administrimit të këtyre deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar korrespondencave përkatëse me institucionet ndihmëse në procesin e rivlerësimit, Komisionit i ka rezultuar se: [...] ***Për shtetasin ****.*** ka filluar procedimi penal me nr. **** i vitit 2011, për veprën penale të parashikuar në nenin 283 të K. Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, procedim i cili është pushuar në datën 20.3.2012, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për shtetasin ****.***, në datën 7.9.2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka filluar procedimin penal nr. ****, për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande Publike” e “Falsifikimit të dokumenteve”, sipas neneve 248, 258 e 186/2 të Kodit Penal, në ngarkim të të gjykuarve ****.***, ****.***, ****.***, ****.***, ****.***, ****.***, ****.*** e ****.***.***

28. Komisioneri Publik, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ mbi procedimet e këtyre shtetasve dhe veprave penale për të cilat janë hetuar/gjykuar, vlerëson se Komisioni me të drejtë, në kuptim të kritereve të rivlerësimit të figurës së magjistratit, i është drejtuar organit të DSIK-së, ku përmes shkresës nr. **** prot., datë ****.12.2019, i ka kërkuar informacion nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ose ka krijuar kontakte të papërshtatshme me to, në periudhën përkatëse.

29. Nisur nga të dhënat e administruara në vijim nga DSIK, Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për sa më sipër, ka arsyetuar se: [...] *(i) Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës se ka pasur njohje me shtetasin ****.***, i cili është person që është proceduar për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i K. Penal; (ii) Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës se ka pasur njohje me shtetasin ****.***, i cili është person që është proceduar për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i K. Penal. Nga hetimi, Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk ka kontakt me këta shtetas pas vitit 2006, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 [...].*

30. Pas vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka plotësuar saktë Deklaratën e Kontrollit të Figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, si dhe konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

²² Neni 71, Kriteret e vlerësimit: Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme: c- etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit.

31. Komisioneri Publik konstaton se informacioni i administruar në dosje të Komisionit nga DSIK, në rastin konkret, ka pasqyruar rrethana, të cilat lidhen drejtpërdrejt me kontaktet e dyshuara të vetë subjektit të rivlerësimit me këta shtetas.

32. Në këto rrethana, Komisioneri Publik konstaton se Komisioni e ka kufizuar vlerësimin e rezultateve të hetimit administrativ, të paktën për njërin nga këta shtetas, duke i vlerësuar vetëm brenda përcaktimeve të kontrollit të figurës, ndërkohë që ka pasur elemente të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e përmbushjes së kritereve të vlerësimit të etikës profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

33. Nisur nga rrethana e rastit konkret, Komisioneri Publik, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin (JR) 21/2019, prg.15, vlerëson se organet e rivlerësimit, me qëllim për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, duhet të administrojnë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në ligj, dhe njëkohësisht duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës.

34. Sa më sipër, Komisioneri Publik ndan mendimin se rezultatet e hetimit administrativ, në këtë rast, duheshin vlerësuar në raport me etikën e subjektit dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, referuar kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016.

35. Rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për shtetasin ***.***, treguan se Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës²³, nuk ka të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur, ndërsa Prokuroria e Shkallës së Parë Shkodër²⁴, në ngarkim të shtetasit ***.***, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 10.11.2011, për nenin 283/1 të K. Penal. Dosja është pezulluar në datën 19.3.2012, për moszbulim të autorit të krimit dhe është dërguar pranë kartotekës së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

36. Komisioneri Publik konstaton se, me të drejtë, në këtë rast, në raport me parashikimet e nenit 75, pika 4 të ligjit nr. 96/2016²⁵, nuk ka indicie që mund të ngrenë dyshime të bazuara për etikën dhe paanësinë e subjektit të rivlerësimit, pasi trajtimi i procedimit penal, ku ky shtetas ka qenë i përfshirë, është jashtë kompetencës tokësore ku ushtron profesionin subjekti i rivlerësimit.

37. Por, ndryshe nga sa është vepruar në lidhje me verifikimin e situatës së mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin ***.***, nuk konstatohet që Komisioni të ketë kryer të njëjtat verifikime në lidhje me shtetasin ***.***.

38. Për më tepër, që nga hetimi administrativ i Komisionit dhe administrimi në dosje i një vendimi në seancë gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2012-*** (***), datë ***.12.2013, ka rezultuar se shtetasi ***.*** është hetuar, gjykuar dhe dënuar nga ana e prokurorisë dhe gjykatave (prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës), të cilat përfshihen në kompetencën tokësore të prokurorisë për ushtrimin e përfaqësimit të akuzës pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ku ushtron funksionin e magjistratit vetë subjekti i rivlerësimit. Për llogari të *procedimin penal nr. ***/2009 rezulton se shtetasi ***.*** është hetuar, marrë masë sigurimi personal, gjykuar dhe përfundimisht deklaruar fajtor për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës"*.

39. Komisioneri Publik konstaton se gjatë hetimit administrativ të Komisionit, përtej administrimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton të jenë

²³ Referohuni shkresës nr.*** prot.,datë ***.1.2019, të Prokurorisë së Rrethit Durrës.

²⁴ Referohuni shkresës nr.*** prot., datë ***.12.2019, ka informuar Komisionin.

²⁵ 4. Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

administruar akte procedurale (vendime gjyqësore/ankim/rekurs etj.) ose korrespondencë me institucionet përkatëse, për të vërtetuar qenien e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të akuzës, gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit Durrës, të kërkesave gjatë hetimit të kësaj çështje penale (caktimi i masës së sigurisë etj.) ose themelit të saj. Hetimi i këtyre rrethanave, sikundër është kryer nga Komisioni në rastin e shtetasit ***.***, do të mundësonte një vlerësim të plotë mbi etikën dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016.

40. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, elementet e mësipërme, të konstatuara nga aktet në dosje të Komisionit, janë elemente që duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektit, z. Ludovik Dodaj, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi i ankimit

41. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

42. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

43. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

44. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 255, datë 8.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA